



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**

**Nr. 261, datë 13.11.2019**

**PËR**

**FILLIMIN E PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES PËR EMËRIM NË GJYKATËN E LARTË TË KANDIDATËVE, NGA RADHËT E JURISTËVE TË SPIKATUR, PËR POZICIONIN E LIRË TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR.110, DATË 09.07.2019, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 136, pikat 3 dhe 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 49, pikat 6, 7 dhe 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në Kreun V, Seksioni A, pikat 1 dhe 3, të Vendimit nr.102, datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”, mbas realizimit të shortit për zgjedhjen e relatorit,

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarë), për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.110, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Caktimin e z. Ilir Toska si relator për procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarë), për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.110, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**